



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

**Mars, 2021**

Aktivitete të shumta për nder të ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe

## Respekt i përjetshëm për pishtarët e dijes



Viteve të kaluara më 7 mars ambientet e Pallatit të sporteve “1 Tetori” merrnin pamje festive sepse SBASHK organizonte Manifestimin madhështor për të shprehur respektin meritore për kontributin e lartë të pishtarëve të dijes. Kështu do të ishte edhe në 7 marsin e vitit 2021, por për shkak të situatës nga pandemia Manifestimi nuk u mbajt në Prishtinë, por u shpërnda nëpër gjithë komunat e Kosovës dhe në Universitete... (faqe 4)

Vazhdojnë takimet me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve

**Angazhime të përbashkëta në shërbim të anëtarësisë**



Ishte kërkesë dhe dëshirë e shumë prej... (faqe 7)

Intervistë e shkurtër me edukatoren Emine Salihu

**Puna me fëmijë është përvojë e pakrahasueshme**



*U diplomua në Universitetin (faqe 3)*

SBASHK u takua me Ministren e MASHTI-it Arbërie Nagavci

**Gatishmëri për bashkëpunim në shërbim të arsimit**



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren ... (faqe 5)

Ka nisur të realizohet agjenda e zgjedhjeve në SBASHK

**Ky aktivitet do të vazhdojë gjatë gjithë vitit 2021**



Pasi që viti 2021 është vit zgjedhor ... (faqe 5)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Kujtesë për pishtarët e dijes



Jeta e njerëzve kudo në botë ka ndryshuar shumë për shkak të pengesave, streseve e situatave të rënduara që ka krijuar Covid-19. Pandemia ka ndikuar dhe ka krijuar një atmosferë krejt tjetër e të përcjellë me shumë sfida e vështirësi edhe në arsim. Takimet e vazhdueshme nga larg që organizohen me sindikatat anëtare nga Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe nga Internacionalja e Arsimit (EI) tregojnë qartë se kudo në shtetet e botës punëtorët e arsimit përballën me sfida e shumë vështirësi të krijuara nga Covid-19, por që të gjithë angazhohen për rrjedhën e mbarë të procesit mësimor.

Punëtorët e arsimit në Kosovë e kanë edhe më vështirë se shumë nga koleget tanë që janë

nga shtete me ekonomi të zhvilluar, por, si në të kaluarën, edhe sot e gjithë ditën ata janë dëshmuar e po dëshmohen me angazhimin në misionin e tyre fisnik të edukimit të brezave duke u përballur vazhdimisht me armikun që nuk shihet, por që është tepër i rrezikshëm.

Kjo sakrificë dhe ky përkushtim meriton të vlerësohet dhe punëtori arsimor ka shumë nevojë për përkrahje e për një fjalë që jep kurajë. Besojmë se shumica e qytetarëve e dinë këtë dhe shprehin respekt për mësuesin, kurse ata pak individë që, aty e këtu, flasin pa as edhe një argument duke lënduar figurën e mësuesit koha do t'u tregoj se kanë gabuar rëndë dhe nëse kanë sado pak vlerë njerëzore do të ndihen keq e të turpëruar.

Punëtorët e arsimit do të vazhdojnë rrugëtimin dhe me vetëdije do të përballën me sfidat duke dhënë kontribut me vlerë në rrjedhën e mbarë të arsimit edhe në kushtet tepër të rënduara nga pandemia me lutjen dhe shpresën që ne dhe e tërë bota ta fitojmë sa më shpejt betejën kundër Covid-19 dhe të frymojmë e të punojmë lirshëm.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)


Tel. +383(0)38/ 226 940



## Intervista

Intervistë e shkurtër me edukatoren Emine Salihu

### Puna me fëmijë është përvojë e pakrahasueshme



*U diplomua në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan. Punon tani e 22 vite në çerdhen “Gëzimi ynë” në Viti. Për përkushtimin dhe arritjet pesë herë është nderuar nga Drejtoria e Arsimit me titullin “Edukatore e*

*dalluar”. Ndjehet krenare me profesionin e saj sepse puna me fëmijë dhe edukimi i drejt i tyre është mision i shenjtë. Ajo në intervistën e shkurtër për gazetën tonë flet për profesionin e edukatores dhe për angazhimet e aktivitetet sindikale.*

#### Arsimimi sot:

Kush është Emine Salihu?

#### Eminja:

Edukatore e diplomuar në Fakultetin e edukimit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan. Punoj në çerdhen “Gëzimi ynë” në Viti, që 22 vite dhe gjatë gjithë kësaj kohe kam punuar dhe vazhdoj të punoj me grupmoshat e ndryshme tani për tani punoj me parafillor. Përgjatë viteve kam ndjekur edhe kurse dhe trajnime të ndryshme, që janë organizuara nga Ministria e arsimit dhe shoqatat e huaja, të cilat kanë rezultuar në përgatitjen dhe arritjet e mia profesionale. Për punën time jam nderuar me mirënjohje nga Drejtoria e arsimit pesë here me titullin “Edukatore e dalluar”. E gjithë kjo ka qenë një privilegj i jashtëzakonshëm, ngase me të vërtetë puna me fëmijë është një përvojë e pakrahasueshme.

#### Arsimimi sot:

Ky është vit zgjedhor në shoqatat sindikale, si po rrjedh ky aktivitet?

#### Eminja:

Faktikisht jam kryetare e sindikatës që dy mandate, por në institucionin tonë nuk ka filluar ende procedura

e zgjedhjeve për mandatin e ri. Pa tjetër se ne vazhdim do ju njoftojmë për ecurinë e këtyre zgjedhjeve.

#### Arsimimi sot:

A keni informata të mjaftueshme për aktivitetet e SBASHK-ut në nivel qendror?

#### Eminja:

Po patjetër se kemi. Përpiqemi që në vazhdimësi të jemi të informuar, dhe për këtë do shfrytëzojmë rastin të falënderoj kryetarin Kuvendit të sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Vitisë, Kemajl Bislimi, i cili mban kontakte të rregullta me gjithë kryetarët e shoqatave sindikale të komunës sonë duke na njoftuar për gjithçka rreth ngjarjeve aktuale dhe angazhimeve sindikale në nivelin qendror dhe ne i përgëzojmë ata për gjithë angazhimin në shërbim të anëtarësisë.

#### Arsimimi sot:

Si e vlerësoni mbajtjen e mësimit gjatë kohës së pandemisë?

#### Eminja:

Është fakt se pandemia ka sjell probleme në çdo fushë, e kjo sidomos në fushën e arsimit. Por me gjithë atë çerdhja “Gëzimi ynë” nuk ka orë të humbura. Si rrjedhim i kësaj çdo lloj vështirësie e kemi tejkaluar duke mbajtur aktivitetet të shumta online, ndërsa ndonjë orë të humbur e kemi plotësuar gjatë qëndrimit tonë ditor.

#### Arsimimi sot:

Në kolektivin tuaj a keni pasur raste të prekur me Covid-19 dhe si është menaxhuar situata?

#### Eminja:

Fatkeqësisht virusi Covid19 ka prekur edhe stafin tonë. Mirëpo drejtoresha e çerdhes Mirlinda Sylejmani ka marrë masa të menjëhershme duke menaxhuar situatat në mënyrën më të mirë dhe profesionale. Çerdhja është mbyllur për dy javë gjatë kohës kur ka pasur infektim në staf, ndërsa ne dy raste kemi zëvendësuar edukatorët e infektuar duke vazhduar kështu aktivitetet tona në institucionin edukativ.

## Gjatë muajit

Aktivitetet të shumta për nder të ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe

### Respekt i përjetshëm për pishtarët e dijes



Viteve të kaluara më 7 mars ambientet e Pallatit të sporteve “1 Tetori” merrnin pamje festive sepse SBASHK organizonte Manifestimin madhështor për të shprehur respektin meritor për kontributin e lartë të pishtarëve të dijes. Kështu do të ishte edhe në 7 marsin e vitit 2021, por për shkak të situatës nga pandemia Manifestimi nuk u mbajt në Prishtinë, por u shpërnda nëpër gjithë komunat e Kosovës dhe në Universitete.

Kjo nuk ia humbi madhësinë kësaj feste sepse SBASHK në koordinim me kryetarët e kryesitë e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve organizoi nëpër komunat e Kosovës ceremoni festive me kolegët e pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e këndej, që kanë punuar me vite e dekada në çerdhe, Arsimin Parauniversitar apo Universitete, duke u ndarë mirënjohje për punën dhe përkushtimin e tyre e duke kujtuar me fjalë rasti kontributin e lartë të pishtarëve të dijes që nga shkolla e parë shqipe e deri në ditët e sotme.



Në këto takime festive është folur edhe për sfidat dhe angazhimin në shërbim të arsimit nëpër vite e dekada dhe me krenari është vlerësuar se SBASHK-u ka arritur të realizojë në tërësi kërkesat e anëtarësisë dhe kështu do të vazhdohet edhe sot e gjithmonë.



SBASHK u takua me Ministren e MASHTI-it Arbërie Nagavci

## Gatishmëri për bashkëpunim në shërbim të arsimit



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u takuan sot me Ministren e MASHTI-it, Arbërie Nagavci për ta përgëzuar për detyrën dhe për t'i shprehur përkrahje në angazhimet në shërbim të arsimit.

Ministrja Nagavci ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën dhe përgëzimet e pastaj ka shpalosur shkurtimisht planin e angazhimeve dhe është shprehur e gatshme për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit, ngritjes së vazhdueshme të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës në institucionet arsimore. SBASHK –u i premtoi mbështetje në këto angazhime dhe u zotua se do të japin kontributin maksimal në kuadër të kompetencave që ka.

Të dy palët u pajtuan që në takimin e radhës të bashkëbisedojnë për çështje konkrete dhe të angazhohen bashkërisht për realizimin e tyre

Ka nisur të realizohet agjenda e zgjedhjeve në SBASHK

## Ky aktivitet do të vazhdojë gjatë gjithë vitit 2021

Pasi që viti 2021 është vit zgjedhor në SBASHK, organet gjegjëse të sindikatës sonë kanë bërë gjithë parapërgatitjet me qëllim që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë dhe të respektohet në përpikëri Statuti i SBASHK-ut, që saktëson qartë rregullat që duhen zbatuar me qëllim që zgjedhjet të realizohen ashtu si duhet dhe të vihet në jetë vullneti i anëtarësisë përmes votës së fshehtë e të lirë. Bazuar në Statutin dhe organizimin e SBASHK-ut zgjedhjet fillimisht mbahen në shoqatat sindikale në të gjitha institucioneve arsimore që nga çerdhet e deri në Universitete, por edhe në shoqatat sindikale të institucioneve të kulturës, që janë pjesë e sindikatës sonë.



Vlen të theksohet se në një numër shoqatash kudo në Kosovë tani më janë mbajtur zgjedhjet dhe se



ky aktivitet është në vazhdim e sipër. Organet vendimmarrëse dhe ato ekzekutive të SBASHK-ut me qëllim që zgjedhjet të kenë rrjedhë të mbarë dhe të zbatohen në tërësi rregullat e përcaktuara në Statut janë pajtuar që në çdo komunë dhe universitete të formohen komisionet e përcjelljes së zgjedhjeve dhe se pa praninë e kryetarit të nivelit komunal apo personit të autorizuar nga kryesitë komunale zgjedhjet në cilën do shoqatë nuk do të konsiderohen të pranueshme.



do të nominohen përfaqësues për Këshillin Drejtues, aprovimi i të cilëve do të bëhet në Kongresin e SBASHK-ut, që do të mbahet në javën e fundit të muajt shkurt 2022, apo në javën e parë të marsit të atij viti. Procesi zgjedhor pastaj do të vazhdojë edhe në Kuvendet e tri niveleve arsimore dhe të kulturës. Ky aktivitet do të mundësojë përfaqësimin e denjë të të gjitha niveleve të arsimit dhe të kulturës në organet vendimmarrëse dhe në Kongresin e SBASHK-ut, si organi më i lartë i sindikatës sonë.



Me të përmbyllur të këtij aktiviteti do të kalohet në zgjedhjet në Kuvendet sindikale në të gjitha komunat dhe në Universitet duke u zgjedhur kështu në garën mes dy e më shumë kandidatëve e me votën e fshehtë e të lirë organet e nivelit komunal të Universiteteve.

Ministrja Nagavci ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën dhe përgëzimet e pastaj ka shpallur shkurtimisht planin e angazhimeve dhe është shprehur e gatshme për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit, ngritjes së vazhdueshme të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës në institucionet arsimore. SBASHK –u i premtoi mbështetje në këto angazhime dhe u zotua se do të japin kontributin maksimal në kuadër të kompetencave që ka.



Të dy palët u pajtuan që në takimin e radhës të bashkëbisedojnë për çështje konkrete dhe të angazhohen bashkërisht për realizimin e tyre.

Po ashtu në këto Kuvende zgjedhore do të zgjedhën edhe delegatët për Kongresin e radhës dhe

Vazhdojnë takimet me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve

## Angazhime të përbashkëta në shërbim të anëtarësisë

Ishte kërkesë dhe dëshirë e shumë prej kryetarëve të nivelit komunal sindikal që të takohen nga afër pas shumë takimeve nga larg dhe të bashkëbisedojmë dhe të marrin materiale sindikale dhe Kontratën e re Kolektive të Arsimit në kopje të mjaftueshme për udhëheqës sindikal të shoqatave, drejtorë shkollash dhe për DKA-të. Stafi qendror i SBASHK-ut ua realizoj këtë kërkesë duke marrë të gjitha masat për të respektuar Rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik me organizimin më 13 mars të këtij takimi në sallën e madhe të mbledhjeve në Qendrën e Studentëve.



Duke hapur këtë takim dhe para se të kujtonte pikat e rendit të punës, kryetari Rrahman Jasharaj ka përgëzuar pjesëmarrësit për organizimet me sukses të ceremonive festive nëpër komuna kushtuar ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe. “Ky aktivitet i organizuar mirë iu kushtua pishtarëve të dijes nëpër vite e dekada dhe në shenjë mirënjohje për punën e përkushtuar të kolegëve tanë të pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e deri tani atyre u janë dhënë mirënjohje nga SBASHK-u”, ka deklaruar Jasharaj e pastaj shumë nga kryetarët e nivelit komunal sindikal kanë treguar momente nga këto ceremoni dhe i janë falënderuar stafit qendror që ka publikuar në medie shkrime nga këto aktivitete.

Ata kanë treguar edhe për aktivitetet dhe sfidat që kanë të bëjnë me angazhimet sindikale në komunat e tyre. Një vend me rëndësi në këtë takim i është dhënë edhe fillimit të procesit zgjedhor nëpër shoqata

sindikale, proces ky që do të zhvillohet gjatë tërë vitit 2021 sepse pas përfundimit të zgjedhjeve në gjithë shoqatat sindikale do të kalohet me zgjedhjet në Kuvendet sindikale komunale e të Universiteteve, me zgjedhjet në kuvendet e niveleve arsimore e duke krijuar kështu kushtet e duhura e të parapara me Statutin e SBASHK-ut për Kongresin zgjedhor, i cili do të mbahet në javën e fundit të shkurtit 2022 apo në fillim të marsit të atij viti.



Me kërkesën e pjesëmarrësve koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka prezantuar para pjesëmarrësve pamjet e gjithë dokumentacionit që ka të bëjë me zgjedhjet dhe ka sqaruar se si plotësohen ato.



Ishte pajtueshmëri e plotë që zgjedhjet nëpër shoqata të monitorohen nga Komisioni komunal zgjedhor dhe ai i Universiteteve dhe se pa praninë e kryetarit komunal a të Universiteteve, apo anëtarëve të autorizuar të Kryesisë, në këto takime zgjedhore rezultatet dhe raportet nuk do të legjitimohen. Pjesëmarrësit e këtij takimi kanë autorizuar kryetarin dhe stafin qendror që të përgatit një plan konkret për

takimet me institucionet qendrore duke caktuar qartë kërkesat parësore. Ata edhe kanë dhënë propozime konkrete se cilat nga çështjet meritojnë prioritet në takimet me institucionet qendrore.




Pjesëmarrësit kanë bashkëbiseduar edhe lidhur me pjesëmarrjen e përfaqësuese të SBASHK në takimin e Këshillit Drejtues të BSPK-së më 27 mars dhe për

përgatitjet që duhet bërë për Kongresin zgjedhor të Konfederatës, që pritet të mbahet në muajin tetor të këtij viti. Pas kësaj Stafi qendror i SBASHK-ut u ka shpërndarë pjesëmarrësve të këtij takimi ekzemplarë të mjaftueshëm të Kontratës së re Kolektive, që do t'u dorëzohen kryetarëve të shoqatave sindikale, drejtorëve të institucioneve arsimore dhe DKA-ve.



## EI në komunikim të vazhdueshëm me sindikatat anëtare SBASHK ndanë përvojat me kolegët nga e tërë bota

Kryetarja e Internacionales së Arsimit (EI) Susan Hopgood, Sekretari i përgjithshëm David Edvards dhe tërë stafi i EI-së duke dëshmuar punë dhe përkushtim janë duke komunikuar e duke mbajtur takime të vazhdueshme me sindikatat anëtare nga e tërë bota me qëllim që të bashkëbisedohet e të këmbehen ide për punë e aktivitete në shërbim të arsimit në situatën tepër të rënduar nga Covid-19. Në të gjithë këtë aktivitet është kyçur edhe SBASHK-u duke prezantuar situatën aktuale në arsimin e shtetit tonë dhe përpjekjet e angazhimet që janë bërë për rrjedhë sa më të mbarë të procesit arsimor, qoftë në institucionet arsimore, qoftë në mësimin nga larg, që ndodhi në pjesën e dytë të vitit të kaluar shkollor.



Në takimin e radhës nga larg të 25 marsit bashkëbisedën e ka udhëhequr zv/sekretarja e përgjithshme Haldis Holst, e cila ka dhënë një raport të vlerësimit të gjendjes në arsim kudo në botë në emër të EI-së e pastaj udhëheqës të autorizuar nga të gjitha Kontinentet janë ndalur konkretisht në përshkrimin e gjendjes së arsimit në shtetet nga ato pjesë të botës. Në këtë takim SBASHK është përfaqësuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarja Vlora Rexhepi Berisha, e cila në gjuhën angleze ka informuar për gjendjen aktuale në arsimin e shtetit tonë dhe angazhimet konkrete të SBASHK-ut në rrjedhën e mbarë të arsimit dhe në arritjet në përpjekje për mbështetje të anëtarësisë duke veçuar se



SBASHK-u edhe në vitin e kaluar shkollor ka bërë shumë angazhime e aktivitete për rrjedhën e mbarë të mësimit duke shtuar angazhimet e komunikimin me gjithë anëtarësinë për të mobilizuar ata edhe për mësimin nga larg.

Përfaqësuesja e SBASHK-ut ka treguar edhe për sfidat, aktivitetet e angazhimet e shumta edhe në kuadër të këtij viti shkollor duke veçuar që në bashkëpunim me mirëkuptim me MASH-in kanë arritur të sigurojnë paga për një vit shkollor për kolegët tanë me sëmundje të rënda kronike, të cilët kështu do të lirohen nga procesi mësimor, duke përmënuar se falë bashkëpunimit mes SBASHK-ut e MASH-it u arrit që Qeveria të ndajë buxhet shtesë për arsimin në mbështetje të arsimit për arsye të kushteve të vështirësuar, mjete këto dedikuar masave mbrojtëse nga Covid, shtesës për kolegët që për arsye të natyrës së punës kanë ngarkesë shtesë të punës dhe

për angazhimin shtesë të punëtorëve tekniko-ndihmës, një numri psikologësh dhe pedagogësh. Përfaqësuesit e SBASHK-ut me kujdes kanë përcjellë gjithë prezantimet e kolegëve tanë nga shtete të ndryshme të botës dhe kanë fokusuar përvojat e tyre për t'i pasur si shembuj të mirë të angazhimeve në të ardhmen.



Vazhdon të shtohet numri i anëtarëve në sindikatën tonë

## Bashkë e në SBASHK



Angazhimi, përkushtimi, përballja me sfidat dhe prezantimi në mënyrë të denjë i zërit të punëtorëve të arsimit kudo në takime në Kosovë, por edhe në aktivitetet sindikale

ndërkombëtare ka bërë që numri i anëtarëve të rinj në SBASHK të shtohet vazhdimisht. Kjo vërehet edhe në dy muajt e parë të vitit 2021.

Bazuar në listat e anëtarësimit dhe statistikat që me kujdes i mban zyrtarja Afërdita Ahmeti në muajin

janar SBASHK-ut i janë bashkuar edhe 347 anëtarë të rinj, kurse në shkurt 224 të tjerë. Kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve edhe gjatë muajit mars kanë vazhduar të sjellin lista me anëtarësime të reja.


Në SBASHK theksojnë se i gëzon ky fakt dhe ata premtojnë se do të vazhdojnë angazhimet në shërbim të anëtarësisë në shenjë respekti e falënderimi për besimin që ata kanë ndaj stafit qendror dhe përfaqësuesve të organeve të SBASHK-ut.

ETUCE vazhdon aktivitetet në shërim të arsimit

## SBASHK pjesë e këtyre angazhimeve

Përveç aktiviteteve të vazhdueshme e komunikimit me sindikatat anëtare Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës ( ETUCE) rëndësi të veçantë i kushton edhe punës së Komiteteve të përhershme. Në Komitetin e të Përhershëm të Arsimit të Lartë dhe Hulumtimit SBASHK-un e përfaqëson prof. dr. Alban Zeneli. Ky

Komitet ka mbajtur takimin zgjedhor në përbërjen e re duke zgjedhur kryetar Rob Copeland nga Britania e Madhe, ndërsa zëvendës kryetar të këtij grupi profesional u zgjodhën, Alessandro Arizeno nga Italia dhe Annette Dolan nga Irlanda.



Një punë të përkushtuar vazhdon të bëjë edhe Komiteti për barazi gjinore në pozicionet vendimmarrëse të sektorëve të arsimit dhe sindikatës. SBASHK-un në këtë komitet e përfaqëson nënkryetarja Vjollca Shala. Në takimin e radhës më 5 mars, 35 ekspertë të sindikatës për barazinë gjinore nga e gjithë Evropa morën pjesë në programin e përbashkët një-ditor të trajnimit ETUI-ETUCE "Sigurimi i barazisë gjinore në nivelin e vendimmarrjes në sektorin e arsimit dhe sindikatave". Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit diskutuan se si të rrisin përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në udhëheqje dhe vendimmarrje në të gjithë sektorët e arsimit dhe kërkimit dhe brenda strukturave të sindikatave, përfshirë zbatimin e Planit të Veprimit ETUCE për Barazinë Gjinore.

Pabarazitë gjinore mbeten një çështje e vazhdueshme në ekonominë dhe shoqërinë tonë dhe sektorët e

arsimit dhe sindikatës nuk bëjnë përjashtim. Pavarësisht nga gratë që përbëjnë shumicën e punëtorëve në sektorin e arsimit në Evropë, ato janë të përfaqësuara në pozitë udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Pjesëmarrësit në trajnim diskutuan çështjen komplekse të ndarjes horizontale gjinore dhe pengesat me të cilat përballen mësueset dhe personeli tjetër i arsimit dhe sindikalistet në përparimin e karrierës së tyre.

Një takim tjetër me rëndësi i organizuar nga ETUCE ishte edhe seminari i parë online, nga tri seminarët e parapara, lidhur me "Sindikatat e arsimit dhe shkollat përfshirëse, Adresimi i nevojave për trajnim të personelit arsimor për arsimin gjithëpërfshirës - Një qasje e tërë shkollës për arsimin gjithëpërfshirës". Në këtë ngjarje sindikale SBASHK-un e kanë përfaqësuar Vjollca Shala dhe Shqipe Dubovci.



## Konferencë tematike e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) **Arsimi në Evropë nga rezistenca në rimëkëmbje**


Duke e parë se pandemia ka krijuar rrethana të reja dhe ka vështirësuar shumë rrjedhën e procesit arsimor kudo në shtetet e Evropës, Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës ka krijuar një agjendë të re të aktiviteteve duke organizuar takime, tryeza e Konferenca të shumta me tema aktuale nga arsimit me qëllim të mbështetjes dhe mobilizimit të vazhdueshëm të 11 milionë anëtarëve për të rezistuar e qëndruar karshi vështirësive e sfidave dhe për të bashkëbiseduar e bartur ide për rimëkëmbjen e arsimit në këtë situatë të re e tepër të vështirë. Në kuadër të këtij angazhimi u organizua më 31 mars edhe një

Konferencë tematike nga larg, pjesë e të cilës ishin edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, Ymer Ymeri e Vlora Rexhepi Berisha.




# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në hapje të kësaj Konference me temën kyçe “Arsimi në Evropë nga rezistenca në rimëkëmbje: Investimet, Reformat, Privatizimi dhe Marrëdhëniet industriale “ kryetari i ETUCE Lary Flanagan dhe drejtorja e përgjithshme Suzan Flocken kanë përshëndetur pjesëmarrësit dhe kanë përgëzuar punëtorët arsimor kudo në Evropë për punën, angazhimin dhe përkushtimin në procesin arsimor, që po përcillet me shumë sfida, por siç u tha, ata po rezistojnë kundër vështirësive dhe po bëjnë edhe të pamundurën në realizimin e misionit të tyre. Ata pastaj kanë treguar për gjendjen në arsim kudo në Evropë duke u ndalur te angazhimet e punëtorëve arsimor në situatën e re dhe duke përmendur shumë sfida, të cilat, siç thanë, tejkalohen më lehtë falë bashkëpunimit, mbështetjes dhe këmbimit të përvojave.



Pikërisht për këtë, panelistët kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit duke u ndalur te momentet aktuale dhe duke ngritur çështje të gjithëpërfshirjës, që është sfida nga më të vështirat dhe duke dhënë ide se si duhet rimëkëmbur sistemet arsimore gjatë pandemisë e sidomos pas saj. Pjesëmarrësit kanë përgëzuar stafin qendror të ETUCE-s për gjithë përkushtimin dhe panelistët për kontributin e dhënë në këtë Konferencë duke u pajtuar se duhet vazhduar komunikimin dhe takimet tematike me qëllim që të krijohet një front i përbashkët i angazhimeve nga të gjithë punëtorët arsimor kudo në Evropë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture